

Durres, me 03/11/2021

**AKT THEMELIMI STATUT**

PER SHOQERINE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

**RENATO – 2021 SHPK**

Mbeshtur ne legjislacionin qe lejon dhe rregullon veprimtarine private ne Shqiperi si dhe baze te vullnetit tim te lire, vendosa te krijoj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar me nje ortak te vetem duke e emertuar : RENATO – 2021 SHPK, me qender kryesore te veprimtarise Durres, Durres, Lagjia nr.17, Rruga Dalip Peza, objekt me nr.pasurie 5/548, Zona kadastrale 8513.

**NENI 1**

Kjo do te jete nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar dhe me ortak te vetem themeluesin e saj Z.Arben Gega.

**NENI 2**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar RENATO – 2021 SHPK te gjithe aktivitetit e saj do ta zhvilloje ne perputhje me ligjet Nr.7638 dt.11.11.1992 " Per shoqerite tregtare" dhe Nr.7667 dare 28.01.1993 si dhe aktet e tjera nenligjore te nxjerra ne baze te ketyre ligjeve.

**NENI 3**

Qendra e aktivitetit do te jete Durres, Durres, Lagjia nr.17, Rruga Dalip Peza, objekt me nr.pasurie 5/548, Zona kadastrale 8513, Republika e Shqiperise.

**NENI 4**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar RENATO – 2021 SHPK ne objektin e veprimtarise se saj do te kete : Importin dhe tregtimin me shumice dhe pakice te robeve te perdorura.

**NENI 5**

Per realizimin e objektiveve te shoqerise dhe per arritjen e rezultatit ekonomik, ortaku i vetem dhe themelues i saj Z. Arben Gega , cakton kapital fillestar te themelimit te shoqerise ne shume prej 5,000 (pese mije) lekesh , s'ume e cila do te depozitohet ne arken kryesore te biznesit per shpenzimet e saj te para.

#### NENI 6

Kapitali themelor i shoqerise mund te shtohet ne cdo rast kur shoqeria ka realizuar objektivat e saj dhe ka interes per zgjerimin e veprimtarise qe zhvillon, gjithmone brenda kuadrit ligjor te miratuar.

Po ashtu shoqeria ka te drejte te beje pakesim te kapitalit te saj fillestar, kjo ne rastet kur veprimtaria financiare e shoqerise ka tregues negative. Pakesimi i kapitalit themelor te shoqerise lejohet deri ne masen e humbjeve financiare qe aktualisht kane mbetur dhe nuk ka mundesi te mbulohen me fondet e caktuara ne kete drejtim.

#### NENI 7

Krijuesi i shoqerise RENATO – 2021 SHPK ka te drejte te tjetersoje pjese te kapitalit te shoqerise ose gjithë shoqerine, duke respektuar kerkesat e ligjit Nr.7639 dt.19.11.1999 si dhe dispozitat perkatese ne K.C. per kontratat.

#### NENI 8

Organi drejtues i shoqerise eshte:

- ADMINISTRATORI I SHOQERISE

Proceduara per caktimin e administratorit eshte e percaktuar ne statutin e shoqerise, dhe ne liste e vendos ne menyre individuale ortaku I vetem i shoqerise.

Qe ne momentin e themelimit te shoqerise, eshte vendosur qe administrator i saj te jete Z. Arben Gega.

#### NENI 9

Administratori i shoqerise Z. Arben Gega, ka te gjitha te gjithë te drejtat per te udhehequr shoqerine dhe per ta perfaqesuar ate ne te gjithë aktivitetin e saj ekonomik, juridik, kontraktual dhe marredhenie me personat e punesuar.

#### NENI 10

Shoqerisa merr persiper dhe garanton respektimin e Ligjit per Kontabilitetin ne Shqiperi dhe respektimin e informacioneve sipas ligjit.

#### NENI 11

Per mbajtjen e llogarise dhe kapitalit themelor, shoqeria cel librin e llogarive ku do te kryhen shenimet e te gjitha levizjeve ne kapitalin themelor dhe ndryshimet e nevojshme te kryera ne te.

#### **NENI 12**

Shoqeria ka te drejte te punesoje shtetas shqiptar ose te huaj sipas nevojave te shoqerise, duke krijuar me ta marredhenie punesimi.

Per kete arsyse do te respektohet Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise dhe legjislacioni mbi Sigurimet Shoqerore.

#### **NENI 13**

Ortaku i vetem ka te drejte te vendose per vazhdueshmerine ose jot e veprimtarise se shoqerise. Ne rast se vendos per prishje te shoqerise, ai vete cakton Kohen dhe menyren e likujdimit te shoqerise, duke caktuar dhe komisionon e likujdimit si dhe likujdatoret.

#### **NENI 14**

Dispozitat e aktit te themelimit jane te detyrueshme per t'u respektuar si nga administrator i shoqerise dhe te gjithë personat e tjere qe kane lidhje pune me kete shoqeri.

KRIJUESI I SHOQERISE

RENATO - 2021 SHPK

ARBEN GEGA

